



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur në takimim e Ekzekutivit të Komunës me qytetarë të Podujevës dhe fshatrave përreth, mbajtur më 14 qershor 2018

Takimi filloi në orën 14;10, dhe u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

Takimin e hapi dhe kryesoi z.Isuf Latifi, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

Pjesëmarrës nga Ekzekutivi i Komunës ishin z.Vezir Januzi drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z.Durim Salihu drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, z.Faik Muçiqi drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, z.Abaz Llugaliu drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë, z.Agim Blakqori drejtor i Drejtorisë së Arsimit.

Pjesëmarrësit tjerë në këtë takim janë të evidentuar dhe nënshkruar në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë e këtij procesverbali.

Çështja: Dëgjim buxhetor për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2019/01

Isuf Latifi, drejtor i DBF, e hapi takimin duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje, me që rast i njoftoj të pranishmit për procesin e përgatitjes së projektbuxhetit të Komunës për vitin 2019 dhe projekteve prioritare për vitet 2020 / 2021, buxhet i cili është përcaktuar fillimisht mbi bazën e Kornizës Afatmesme Buxhetore 2019/01 dhe Qarkores Buxhetore 2019/01 të Ministrisë së Financave si dhe projeksionet fillestare të projekteve kapitale, që do të përfshihen në projektbuxhetin e Komunës, ndër të tjera theksoi, qëllimi i këtyre dëgjimeve është që qytetarët të paraqesin nevojat dhe prioritetet e investimeve në secilin lokalitet, me qëllim që në planifikimet buxhetore të hyjnë projektet që janë me interes të tyre. Me projeksionet buxhetore për tri vitet e ardhshme janë planifikuar investime në infrastrukturë, të cilat do të ndihmojnë zhvillimin ekonomik, shërbime më efikase komunale dhe krijimin e të hyrave vetanake. Buxheti i Komunës për vitin 2019 pritet të jetë rreth 22 milionë euro, nga të cilat rreth shtatë (7) milionë euro do jenë për investime kapitale.

Andaj pa humbur kohë, fjala është për Ju të nderuar pjesëmarrës dhe kërkoj që të kontribuoni me propozime dhe kërkesa për investime në projekte konkrete, të cilat do të shqyrtohen nga Ekzekutivi i Komunës.

Ali Selmani, nga fshati Gllmnaik, (Lagja e Llapashticëve), paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës së Lagjes së cekur për të cilën siç tha qe dy vite është bërë projekti i asaj rruge në gjatësi rreth 1 km, dhe është dorëzuar në Komunë, por e cila në këtë vit nuk është realizuar në tërësi por janë asfaltuar vetëm rreth 400 m, për të cilën tha se mendoj që është devijuar projekti përkatësisht është ngatërruar rr. "Janina" me rr. "Sali Selmani". Kërkoj të informohemi se kur do të asfaltohet rruga e Lagjes Selmani.

Bajram Vokri, përfaqësues i fshatit Sfeqel, ne si komunitet i fshatit kemi bërë dhe dorëzuar projektet e fshatit por që ende nuk kanë filluar të realizohen, andaj kërkoj që projektet e njëjta të

realizohen, të cilat edhe i përsërisim e që besoj se të gjitha Drejtoritë i kanë kërkesat tona. Po ashtu kërkesa tjera janë:

-zgjerimi dhe pastrimi i Lumit

-asfaltimi i disa rrugëve dhe rrugicave rreth 4 km, në total.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, sqarim, sa i përket projekteve të dorëzuara në Komunë të cilat janë të parapara për vitin 2018, një pjesë e madhe e tyre janë në procedura dhe janë përfshirë në planifikimi, mirëpo ne sot jemi për të marrë propozimet dhe kërkesat e Juaja për vitin 2019 dhe prioritetet për 2020 / 2021, prandaj të fokusohemi në këtë.

Sabit Jetullahu, nga fshati Llapashticë, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës në Lagjen Jetullahu për të cilën tha se është bërë projekti dhe është dorëzuar në Komunë në vitin 2016 por që ende nuk ka filluar të realizohet.

Ramush Jupolli, përfaqësues i fshatit Shajkoc, paraqiti kërkesën për asfaltimin e rrugës në Lagjen Sinani për të cilën tha se është lënë anash edhe përkundër që ata banorë e kanë hartuar projektin dhe kanë dorëzuar në Drejtorinë përkatëse.

Avdullah Softolli, përfaqësues i fshatit Lladoc, paraqiti kërkesat:

-intervenim me zhavorr ose asfaltim të rrugës Mehana rreth 500 – 600 m, duke arsyetuar se e njëjta është e pakalueshme dhe në atë Lagje është një familje e cila ka të sëmurë, dhe që është në gjendje të mjerueshme.

-intervenim në rrugën e Lagjes Jahaj, e cila po ashtu është e pakalueshme.

Mursel Fazliu, nga fshati Balloc, paraqiti kërkesën për ndërhyrje në rrugën e Lagjes, rreth 70-80 m, asfaltim ose të paktën me zhavorr.

Vehbi Pdivorica, përfaqësues i fshatit Dumosh, fillimisht shprehi falënderime Komunës së Podujevës për investimet e bëra në fshat. Në vazhdim paraqiti kërkesat, si në vijim:

-ndërtimin e trotuarit nga shkolla në brendi të fshatit

-zgjerimin dhe pastrimin e Lumit

-asfaltimin e rrugës në Lagjen Paçarada

-ndërtimin e kanalizimit në rrugën ku janë dy shtëpi e cila gjendet afër aeroportit.

Fadil Gërguri, nga fshati Siboc i Poshtëm, paraqiti kërkesat, si vijon:

-ndërtimin e trotuarit nga hekurudha në drejtim disa shtëpive të fshatit

-asfaltimi rrugës Kaçybeg – Siboc i Poshtëm

-dezinfektimi i fshatit, me theks afër lumenjve, kërkesë elementare

-zgjerimi dhe pastrimi i Lumit

Osmon Bahtiri, përfaqësuesi i fshatit Gllamnik, paraqiti kërkesat, si në vijim:

-ndërtimi i kanalizimit në Lagjet Musaj, Haziri, Muharremi, Kodrollët, Veliu, Kosumi dhe Dërllupi

-lidhjen e kanalizimit të disa Lagjeve në kolektorin kryesor

-zgjerimin, pastrimin dhe dezinfektimin e Lumit duke përfshirë dy pjesët e fshatit

-asfaltimin e rrugës Gllamnik – Konushec rreth 150 m, dhe ndërtimin e urës

-ndërtimi i trotuarit nga magjistralja përgjatë rrugës kryesore të fshatit

-ndërtimi i trotuarit në Lagjen Kosumi

-largimin e mbeturinave (deponive ilegale) dhe marrjen e masave për parandalimin e hedhjes së mbeturinave në vende ilegale.

-ndërtimin e një qendre të edukatës fizike në hapësirën e shkollës së fshatit

-paraqitjen e kërkesave Ministrisë kompetente nga ana e Komunës për ndërtimin e një rrethrotullimi përgjatë magjistralses e cila është duke u punuar, përkatësisht në vendin ku lidhen dy pjesët e fshatit.

-kërkesë për vazhdimin e asfaltimit të disa rrugëve për të cilat janë dorëzuar projektet dhe kanë filluar të asfaltohen por tash së fundmi janë ndalur punimet, rrugë të cilat lidhin fshatin Gllamnik me fshatrat përreth

Fahrudin Mahmuti, përfaqësues i fshatit Siboc i Epërm, paraqiti kërkesat si në vijim:

- vendosja e ndriçimit në rrugën kryesore të fshatit
- ndërtimi i trotuarit rreth 1300 m, tek Lagja Simnica
- asfaltimi i disa rrugicave të fshatit
- ndërtimi i fushës së sportit në oborrin e shkollës
- zgjjerimi dhe pastrimi i Lumit Llap, sepse po pengohet veprimtaria e bujqve – fermerëve
- furnizimi me mjete arsimore mësimdhënësit e shkollës
- propozim për DBPZHR, subvencionet përkatësisht ndarja e serave të bëhet për 5 ari sepse ashtu siç është duke u praktikuar për 1 ari nuk është e mjaftueshme për gjenerimin e të hyrave nga fermerët, pra është mirë të ndërrohet strategjia.

Ruzhdi Fazliu, përfaqësues i fshatit Dumnicë e Epërme, paraqiti kërkesat si vijon:

- asfaltimin e disa rrugicave të shkurtra në këtë pjesë të fshatit
- intervenimi me zhavorr në rrugën e Lagjes Jaholli, të bëhet e kalueshme
- asfaltimi i rrugës së Lagjes Rudari

Latif Mehmeti, koordinator për bashkëpunim me fshatra dhe lagje urbane të qytetit theksoi, fillimisht kam vërejtje për kryetarët e komuniteteve të fshatrave sepse nuk konsideroj se nuk kanë informata të mjaftueshme rreth projekteve që janë në procedurë dhe atyre që janë planifikime. Gjithashtu jeni në dijeni se nga viti 2016 nuk hartohen më projektet nga vetë banorët e fshatrave.

-kërkesë për DBPZHR, të kontaktoj ndonjë operator ekonomik apo kompani për grumbullimin e qumështi me qëllim të grumbullimit – blerjes së qumështit të disa fermerëve – blegtorëve në pjesën veriperëndimore të Komunës së Podujevës të cilët kanë shumë bagëti dhe grumbullojnë sasi të mëdha të qumështit por që nuk kanë ku ti shesin ato, andaj kërkoj të ndërmerret diçka në këtë drejtim.

Rexhep Dauti, përfaqësues i fshatit Llaushë, paraqiti kërkesat si në vijim:

- intervenimi me asfaltim ose zhavorr në rrugën rreth 950 m, në Lagjen Imeri, rrugën rreth 250 m, në Lagjen e Brecakve, dhe rrugën rreth 600 m, e cila lidh dy objektet shkollë.

Abdullah Jaha, nga fshati Reçicë, paraqiti kërkesën për intervenim në rrugën nga Përmendorja sepse është bërë e pakalueshme nga reshjet e shumta, duke arsyetuar se përveç tjerash ka edhe fermer – bujq të shumët të cilët veprojnë në atë zonë por që rruga paraqet probleme.

Blerim Behrami, nga fshati Balloc, paraqiti kërkesat si në vijim:

- asfaltimin e rrugës afër shkollës e cila lidh 9 shtëpi
- asfaltimin e rrugës në Lagjen e Bunjakve
- asfaltimin e rrugës në Lagjen Keqekollve
- asfaltimin e rrugës në Lagjen Pollomi

Patriot Rudari, nga fshati Shajkoc, paraqiti kërkesat si në vijim:

-asfaltimi i rrugëve; rr. "Regjep Agushi" (tek Përveticët) -230 m, rr. "Shaban Agushi" (tek Përveticët) – 160 m, rr. "Rifat Agushi" (Lagja Musolli) – 500 m, rr. "Ahmet Mehmeti" (Lagja Mehmeti – Musolli) – 500 m, rruga tek Hoxha – 165 m, rr. "Jupa Jupolli" (Islamovit) – 295 m, rruga në Lagjen e Llapashticve – 90 m, rr. "Muharrem Rudari" (Lagja Ukelli) – 175 m, rr. "Zeqir Mekolli" (Lagja Mekolli) – 240 m, rruga në Lagjen Bekollt – 230 m, rruga tek Lagja Baraint – 400 m, dhe për rrugën Shajkoc – Dumosh në gjatësi rreth 2.15 km, të kërkohet nga Ministria asfaltimi i saj.

-ndërtimi i kanalizimit në Lagjet Maqastena dhe Obrazhdët

-rregullimi me zhavorr i rrugës Sjakoc – Lladoc

-vendosja e ndriçimit publik në rrugët kryesore

-mbulimi i prroit nga Lagja Musolli deri tek Lagja Baraina në gjatësi rreth 850 m

-ndërtimi i sallës së edukatës fizike për nxënës.

Xhafer Rrsutemi, nga fshati Repë, paraqiti kërkesën për rregullimin në këtë vit me zhavorr të rr. "Marshi i UÇK" në gjatësi rreth 800 m, dhe përfshirjen e saj për asfaltim në vitin e ardhshëm. **Vezir Januzi**, drejtor i DBPZHR, theksoi, tju them të drejtën prita kërkesa dhe propozime konkrete në sektorin e bujqësisë sepse siç jemi në dijeni është sektor mjaft i rëndësishëm për zhvillimin e Komunës së Podujevës, por me përjashtim të z.Fahrudin Mahmutit, nuk dëgjova diçka të tillë. Ne si Drejtori kemi shumë kërkesa nga ana e fermerëve të interesuar për subvencione të ndryshëm në sektorin e bujqësisë, pa përjashtuar edhe sektorët tjerë. Sa i përket propozimit të personit të cekur, mund të them se Komuna nuk ka kapacitete buxhetore për ndarjen e serave për 5 ari sepse është një kosto e madhe kjo, mirëpo vazhdimisht për ndarjen e subvencioneve për projekte përkatëse jemi bazuar në kërkesat e qytetarëve – fermerëve.

Vlen të theksohet se Komuna e Podujevës është pothuajse e vetmja që ka ndarë subvencione pa participim të aplikantve dhe për këtë duhet të falënderohet Kryetari i Komunës.

Sa i përket çështje së ngritur nga z.Latif Mehmeti, vërtetë është gjendje shqetësuese që ata fermer – blegtorë nuk mund të shesin qumështin e tyre sepse nuk kemi ndonjë fabrikë apo kompani përkatëse që do të merrej me këtë, mirëpo ne do të mundohemi të gjejmë zgjidhje.

Xhafer Emini, përfaqësues i fshatit Peran, në formë të shkruar dorëzoi kërkesat si në vijim:

- asfaltimin e rrugëve në Lagjet: Kërrtoku, Xhemajli, Ahmeti dhe disa rrugica në Lagjen Plakolli
- ndërtimi i kanalizimit në Lagjet Xhemajli dhe Plakolli, si dhe në Lagjen tek shkolla
- ndërtimi i urave në Lagjet; Ibrahim, Kërrtoku, në rr. "Ismet Beqiri" dhe dy ura në Lagjen Sylja.
- vendosja e një gypi për apsorvimin e ujit në rr. "Ismet Beqiri" (afër fushës së futbollit "Anuari" me arsyetim se ka qarkullim të nxënësve në atë rrugë e cila gjatë reshjeve grumbullohet sasi e madhe e ujit që vie nga kodrat dhe që paraqet rrezik.

Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit, i dha sqarime dhe arsyetimet e nevojshme rreth çështjeve të ngritura nga disa prej pjesëmarrësve në debat. Po ashtu theksoi se ne si Komunë, në mandatin e kaluar është fjala, kemi marrë parasysh të gjitha kërkesat për asfaltim të cilat na janë sugjeruar nga përfaqësuesit e fshatrave, këtë e them duke u bazuar edhe në atë që e tha përfaqësuesi i fshatit Shajkoc gjë e cila nuk qëndron aspak sepse ka po i njëjti që ka sugjeruar të asfaltohet rruga në Lagjen Bekolli e jo ajo që e ceku më herët.sa i përket ruajtës së ambientit, kërkoj që bashkërisht të ndërmarrim veprime konkrete sa i përket ambientit. Ne jemi në proces të futjes në sistemin e menaxhimit të mbeturinave të gjitha fshatrat e Komunës së Podujevës, gjë për të cilën së shpejti Drejtorië kompetente të Komunës do të thërrasim një takim me përfaqësuesit e fshatrave me të cilët do të diskutojmë këtë çështje dhe të gjejmë një zgjidhje me qëllim të ruajtjes së ambientit. Andaj edhe njëherë ju ftoj për bashkëpunim në këtë aspekt.

Faik Muçiqi, drejtor i DSHPMSH, falënderoj të pranishmit për pjesëmarrje dhe për kërkesat – propozimet e tyre gjatë këtij debati. Dha disa sqarime dhe arsyetime veç e veç rreth disa çështjeve të ngritura paraprakisht nga pjesëmarrësit. Ndër të tjera theksoi, shumë nga parafolësit bënë propozime dhe kërkesa për projekte të cilat janë procedura dhe që do të realizohen në këtë vit, mirëpo si duket përfaqësuesit e disa fshatrave nuk janë në dijeni plotësisht për projektet që do të realizohen në këtë vit dhe tani kërkohen realizimi i po të njëjtave, i cek disa prej tyre.

Gjithashtu gjatë debatit pati kërkesa dhe propozime të cilat ishin të arsyeshme të përfshihen në buxhetin e Komunës për vitin 2019 por edhe të atilla për dy vitet vijuese, të cilat me siguri që ne si Drejtori do t'i analizojmë dhe do t'i marrim parasysh. Sa i përket çështjeve teknike që mund të jenë në terren, urdhëroni paraqitni në Drejtori dhe ato do të rregullohen shumë shpejt sepse ne kemi kontrata për çështje të tilla siç janë riparimet, ndërhyrjet etj të ngjashme.

Isuf Latifi, drejtor i DBF, falënderoj të pranishmit, dhe shtoi, nga ky takim përveç tjerash mund të dalim me një konstatim se në Komunën e Podujevës është punuar mjaft shumë, viteve të fundit sidomos, nuk ka fshat që të paktën (minimum) nuk i kanë të asfaltuara rrugët kryesore dhe ndërtimin e kanalizimeve kryesore, pa përmend projekte tjera. Mandej shumica e fshatrave janë të lidhura mes vete me infrastrukturë dhe kanalizime.

Vlen të theksohet se një numër i projekteve realizohen nga të hyrat vetanake, mirëpo arkëtimi i tyre nuk është në nivelin e kënaqshëm sepse nga ana e qytetarëve nuk bëhet shlyerja e obligimeve ndaj Komunës, prandaj në këtë aspekt shfrytëzoj rastin të kërkoj bashkëpunimin e Juaja si përfaqësues të fshatrave që të merreni më shumë me vetëdisjësimin e banorëve sa i përket pagesës së tatimit në pronë në veçanti, ngase është të gjitha mjetet e grumbulluara nga tatimi në pronë kthehen drejtpërsëdrejti në investime për interes të përgjithshëm në lokalitete të ndryshme.

Takimi përfundoi në orën 15:30

Procesverbalin e mbajtën:

Sabedin Namani

Enis Sheholli

Podujevë,

14 qershor 2018

Drejtori i DBF

Isuf latifi